



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për ndarjen e mjeteve, si ndihmë Komunës së Preshevës me rastin e fatkeqësive natyrore.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50,000.00 € dhe merren nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Administratës.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Prishtinës ia ndan Komunës së Preshevës për sanimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e vërshimeve.

**IV.**

Mjetet e cekura sipas pikës II të këtij vendimi, do të derdhen në xhirollogarinë e hapur të Komunës së Preshevës për këtë fatkeqësi natyrore.

**V.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

**VI.**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-120/03-112390/21, më 16.06.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

